



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 111, Datë 23.05.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 85, DATË 24.04.2025,
“MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SH.P.K
PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SAJ**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.05.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1064 prot., datë 21.05.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 85, datë 24.04.2025, mbi kërkesën e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”

Konstatoi se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. është autorizuar nga bordi i ERE-s, me vendimin nr. 85, datë 24.04.2025, për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj. Ortaku i vetëm që kontrollon interesat e shoqërisë bëhet Z. Alfred Sadikaj. Shoqëria mbetet e detyruar të sigurojë të gjitha autorizimet dhe miratimet përkatëse nga palë të treta, në rast se kjo kërkohet nga kuadri ligjor dhe rregullator. Gjithashtu, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi i ndryshimit në ekstraktin historik të regjistrit tregtar, shoqëria duhet të depozitojë këtë dokument në ERE. Ky vendim është objekt rishikimi nga ana e ERE-s, në varësi të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara më sipër.

1. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria

- ERE me shkresën nr. 1064/11 prot., datë 28.04.2025 ka njoftuar shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s mbi dhënie e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë, duke i sjellë në vëmendje mbajtjen në konsideratë të plotësimit të kushteve të lëna në vendimin nr. 85/2025.

2. Vlerësimi për përmbushjen e kushteve

- Nga shqyrtimi i shkresës së shoqërisë me nr. 1064/12 prot., datë 12.05.2025, rezulton se kjo e fundit ka dorëzuar pranë ERE-s ekstraktin historik të regjistrit tregtar, të vulosur elektronikisht nga QKB në datën 08.05.2025, nga i cili vërtetohet se është reflektuar ndryshimi i ortakut që kontrollon interesat e saj.

- Në përputhje me pikën 4, të vendimit nr. 85, datë 24.04.2025 shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i ndryshimit të ortakut që kontrollon interesat e saj.
- Në këtë kuadër, dokumentacioni i paraqitur konfirmon përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në pikën 4 të vendimit, dhe si i tillë, vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet. Me shfuqizimin e pikës 4 të vendimit nr. 85, datë 24.04.2025, nuk gjen më zbatim as pika 5 e tij, për rrjedhojë, vlerësohet edhe shfuqizimi i saj.

3. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Bazuar në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 4 dhe 5 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 85, datë 24.04.2025, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, të njoftojë shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI